

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8 JH-7
A 43

BARDHYL AJAZI

MOZAİK HUMORİSTİK



vjersha

81H-2

A43.

BARDHYL AJAZI

**MOZAIK
HUMORISTIK**

- vjersha satirike
- fabula
- epigrame
- epitafe



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


SHKËNDIJA NGA METALURGJIA

Nga gryka e furrnaltës
vërshoi i kuq zjarr
çeliku i parë shqiptar
e xixa shumë lëshoi,
sa armiqtë i verboi.

Një shkëndijë i ra tek flinte fashistit në
ballë:

— Oh, mama mia,
sa dukuri e rrallë,
se nuk ka mundësi
të shkrihet çelik në Shqipëri!
E ku, në Elbasan,
kjo është shaka, se e mbaj mend mirë,
atjë s'kishin as ç'të hanin,
as bukë misri me shëllirë.
Një femër s'pata parë në atë djallo qytet,
ku hiqe varfëria, ku nxinin ferekhetë.

Kujtime ku m'u zgjuat dhe gjakun më
bëtë ujë,
kujtova ferekhenë, që pas i rashë dikur!



Sytë për t'i parë.
Por, ah, međet, nagantën ajo më vuri në
ballë
dhe në s'vdiqa atë ditë,
me vrou sot kjo xixë!
Një tjetër shkëndijë ra mbi një eses
— Jo, kjo grimcë, me siguri
është pluhur kozmik,
se nuk ka absolutisht mundësi,
që atje në Shqipëri

të prodhohet çelik!

E kam ndërmend atë që quhet Elbasan,
dukej nga ajo e mallkuar Kërrabë,
ku autokolonat tona ranë në lak,
në lakun e tmerrshëm partizan,
e tërë atë të mallkuar rrugë me zigzage
e lamë me kocka dhe tanke,
nga ca palo dyfegje.


Kurse tani me kryqet tona dhe me
helmetat,
fëmijët stolisin dordolecët,
ndaj them se kjo xixë, që duket në
Elbasan,
në goftë e vërtetë,
do të më djegë si një shafran!

Po, Shqipëria prodhoi edhe çelik,
prodhoi bukë, prodhoi gaz dhe dritë.
Të tëra shpresat e tyre shkuan dhe vanë,
shpresat revisioniste e fashiste kudo që
janë,
se ja, shqiptarët grurë dhe barut
të bollshëm dhe të thatë e kanë me grusht,
edhe ky zjarr çeliku i vuri pikë
në pluhur dhe hone u shkrinë demagogjité,
se analiza foli pa mëshirë:
— Çelik i markës më të mirë!

E u shpërndanë xixa anembanë,
mbi disa si bomba të fuqishme,
por mbi miq edhe mbi shokë
si lule të kuqe nga toka socialiste.

Q O S H J A J O N E

Si në stadium,
ku miqtë, pasi ulen vetë
në vendet me biletë
e një andej e një këndej mundohen,
tek shtyjnë njëri-tjetrin dhe shtrëngohen,
që t'i bëjnë vend shokut që rri në këmbë,
ashtu shokët dhe miqtë mua më bënë
vend në një zyrë.



Ngushtë ishim në fillim,
po u zgjeruam,
morëm një tavolinë, raft, komplet për
shkrim,
pastaj disa dhoma në zyra i shndërruam
dhe unë u ngushtova prapë
(megjithëse bënte vapë)
kërkova një shok
të punonim tok
në një tavolinë, në qoshk.
Por... këtë herë
kontrolli punëtor na trokiti në derë
dhe... për nder,
në ndërgjegje na trokiti.

Zëri i masës
na zgjoi,
na përtëriti.
Prandaj në mbledhje morëm zotim
unanim:
Të zbresim në prodhim!

KËSHILLA E SHPËRDORUESIT

— Kurseni mallin, shokë, kurseni,
hidhni sytë rrrotull, ku vemi?
Këto tulla të thyera,
këto dyer të shqyera,
këto eternite e xhamës të bërë copë,
këto dërrasa, që kalben përtokë,
këto hekura të ndryshkura,
këto tuba të shtrëmbëruara,
ky llaç dhe këto arka të harruara,
këto trarë dhe shtylla betoni...
Të gjitha ç'i shikoni
nëpër shesh e s'jua vrasin sytë,
janë mall me vlerë,
që s'kanë të blerë!
Kështu, siç i keni lënë, haptazi duhet
thënë,
(siç tha dhe shoku shef)
ky s'është kursim,

por thjeshtë, shpërdorim,
që duhet t'jua bëjmë ngarkim!
Prandaj, që të mos na ndodhë një gjë e
tillë
dhe unë të mos prish gojë,
dëgjoni një këshillë:
Përplasini të gjitha
në një qoshe larg sheshit,
që të mos i shohin kurrë
sytë e shefit!


«K R I T I K È»

... — Pra, konflikti është ekzaltuar,
roli komunikues,
i të kundërtave antagoniste
është dialektikisht,
diametralisht,
i trashëgimit antik, epik, pikë!
Dramaciteti, përleshja,
kuadri ku zhvillohet ndeshja,
me një tendosje dramatike
është logjik,
disi tragji-komik, pikë!
Të matur
dhe pa e zggjatur,
mund të themi pa frikë,
spetakli ka kalorit,
spikat pathosi dramatik
si dhe një farë... humori
në tërë tablonë, që na jep autorit.

B U R O K R A T I

— Në këtë zyrë të ngrohtë, të ngrohtë,
s'kam ndier as erë, as të ftohtë,
gjynah të qahem, jam mirë shumë,
tërë ditën... gjumë.

Por tani, kjo çikë punë
do ndarë proporcionalisht,
që nga e hëna gjer të shtunë,
që të punoj si zakonisht
çdo ditë nga një orë,
natyrisht,
kur të kem pranë eprorë.



«M I K P R I T J E»

Kur shkova në qytetin E. me shërbim,
takova një shokun tim:

— Ku je, më tha duke më përqafuar,
u bënë kaq kohë bre, që s'jemi parë!

E me të shtrënguar
e me të qarë,
më pyeti:

— Sonte je këtu?

— Jo, — thashë, — mbarova punë dhe do të
shkoj.



— Mos, — ma ktheu, — ç'po dëgjoj,
po të më besosh kam shumë e shumë dëshirë,
ta shtrojmë bashkë me të ngrënë e me të
pirë
e të bëjmë gjatë muhabet. . .

Po ja, do ikërke dhe na i prishke krejt!

— Po fundja, — thashë, — meqenëse
dashke ti sonte edhe po rri.

— Atëherë, — më tha shoku me ton të
ndryshuar, —
Nesër me siguri, kemi për t'u takuar! . . .

«O M B R E L L A»

Shoku Vangjel
kish nevojë për një ombrellë,
se nuk desh të dilte sheshit
e t'i bënte ballë rrebeshit.
Prandaj donte një ombrellë,
që të strukej në të thellë.
Po kush vallë
do ta hante atë valë
për planin që e lanë,
në baltë një gjashtëmujor?

Me arësy objektive, natyrore
(punë shiu, punë dëbore)
kish shkuar mbledhja mujore
në janar,
po tani, në korrik, i thonë behar...



Shoku Vangjel
kësaj here
tërë kuadrin e kaloi nëpër mend:

— Ja ai,
që nuk punon
dhe është shumë indiferent,
por... e di
ka një «të fortë»,
vetëkuptohet s'e përmend në raport.

Ja dhe tjetri,
ku të duash mund ta gjeshë,
veç në punë ca vështirë,
por ama... ka gojën shpatë;
e njoh mirë,
po ta prekësh, merr inat
edhe do fillojë avazë,
kush e di se ç'do të flasë?!
Hap telash,
ja e lashë.

I treti, ka të meta dhe ky,
ama kurrë s'ma ka bërë fjalën dy.
Vërtetë punë nuk mbaron,

por nuk të kundërshton!
Me të thënë
është gati që të shkojë dhe në hënë.

Ja ky tjetri është dembel,
por kudo kräh më del
dhe më mbron,
kur ndonjë më kritikon.
Dhe në rrugë ëmbël flet,
tek thërret:
Shoku inspektor...

Tani vjen ky i fundit,
vetë ombrella ime sot,
po ia vesh në raport
një kritikë dhe ç'kritikë...
Se për nder
ka munguar një herë
në janar a kur qe
dhe të themi të vërtetën,
që atë ditë,
plani mori tatëpjetën.

Ja ombrella, edhe pikë.
Tani kam vetëm frikë.
Kolektivi ç'do të flasë,

se e duam pa masë
si punëtor dhe si njeri.

Ndaj kritika
mund të lindë diskutime,
dhe të bjerë
mbi kokën time!

- FABULA -

QAJNË ME LOT DHELPËR, UJK DHE
ÇAKALL, SE SHQIPONJA I KA SHTËNË
NË HALL

Një herë dhelpra i tha ujkut e çakallit:
— O vellezër,
gjynah që e shohim njëri-tjetrin vëngër,
ky qëndrim është i shtrëmbër,
nuk përputhet me realitetin...
Ne kemi të njëjtën natyrë,
ndryshojmë pak vetëm në... ftyrë,
se ju tregoni forcën, egërsinë,
kurse unë dhelperinë;
dhe thonë se kam ca marifete,
që i bëj të tjerët për vete,
kur është nevoja
(si korbit, që i mora djathin nga goja).
Dhe gjuhën e kam më të stërholluar,
kështu, për shembull, në këtë kotec,
kur mbi viktima të jem shtruar,

flasë embël për... bashkëjetësë.
Ti zërin e ke të mirë, çakall,
britmat e tua, oh, muzikë e rrallë!
Qeratenj më jeni të zgjuar,
hap pas hapi ju kam imituar,
sa u lodha, duke folur për ju mirë,
nuk lashë lajkë dhe përkëdhelje,
se jeni të bukur, të dëlirë,
pothuajse dele.

Për ndër,
aq ju kam lëvduar,
sa bufi me të tjerë,
që gjithmonë më kanë dëgjuar,
flasin për ju si për dy shqera.

Me shqiponjën kam rënë shumë ngushtë,
po e pësoj si dikur me rrushtë.

U lodha me kurthe,. .
por më kot.

Ajo mbi shkëmb qëndron e patundur.
Para saj, ta themi nën zë:
jemi të mundur e të humbur.

Me shqiponjën na ka pjellë, vëllamë,
është një kockë, që dot nuk e hamë;
kockë e fortë, që na ngec në fyt
dhe... na mbyt.

P J E L L È E K E Q E

Tek shkonte në një çeltirë
zonja dhelpër, si në përrallë,
takoi ujkun me çakallin dhe u tha:
— Më dëgjoni që të dy, se kam diçka,
ne mishngrënës jemi që të tre,
por, secili nga ne
 ka specifikën e tij...
Prandaj kam një mendim.
Dua që me të dy ju
sot të bëj dashuri,
 sepse kam një dëshirë,
një këlysh dua të pjell,
që diçka të re të sjell,
 të paparë e të padëgjuar.
Këlysh
që ka për të trashëguar
 një tipar,



antropofag grabitqar,
që tē ketē dinakérinë,
grykësinë
dhe egërsinë..

Pa dyshim
ky pinjoll nē zhvillim
do tē jetē kryqëzim i rrallë,
dhelppér, ujk dhe çakall.
Sa pér emër, s'ka rëndësi,
mund t'ia vini emrin vetë,
nga tē dy, pjellë e tretë.

N J Ė U D H Ė

Tek shkontakte udhës një udhëtar,
qentë zunë t'i lehin me kërcënëm,
atëherë udhëtari i zgjuar
një shkop të fortë mori me rrëmbim
dhe rrugën vazhdoi i qetë e i siguruar.
Po, tek e pa, dikush e qortoi:
— Përse e mban në dorë atë hosten?
Për një qen?
Dhe në ta zëntë rrugën, merre me të
mirë,
e ai, shihe, do të të tundë bishtin me
dëshirë,
duke të lëpirë...
Se, si i thonë fjalës, merret me të mirë qeni
edhe pa qenë hosteni!
— Po, — ia ktheu udhëtari, —
kur shkopin kam në duar,
edhe në m'u sultë ndonjë qen i tërbuar,
me një dru të mirë ia këput në kokë
dhe e lë pa frymë në tokë.

K A U D H E U J K U

Një ujk pa një ka në lëndinë
dhe, meqë ia njihte brirët dhe fuqinë,
nga larg i tha:

— C'po bën ashtu, more ka?

— Po kullos, po ti?

— Ja bre, tha ujku, erdha të ha ca bar në
lëndinë,
të shuaj urinë...

Qeshi kau dhe foli:

— Kur kështu natyrën ke ndryshuar,
edhe bari i njomë të paska shijuar?



— Ja' bre, foli ujku, le ta marrim shtruar.
Gjersa unë haja barngrënësit vetë,
tani ha vetë bar dhe ndjehem i qetë.
M'u afro, nga unë mos u trëmb,
shihmë në daç gojën, nuk kam dhëmbë.

Qeshi prapë kau dhe foli i qetë:
— Unë jam mirë këtu, me ty nuk kam punë,
në daç e provo, në trëmbem unë,
se e di, or ujk, siç e di ti vetë.
Vërtet ti s'ke dhe s'do të kesh dhëmbë,
sepse kam unë brirë edhe të mprehtë,
dhe qëndroj gjithmonë zgjuar dhe në
këmbë.

B L E T A D H E M I Z A

Në një lëndinë, një mizë, një herë
çirrej me potere:

— Jo dhe jo, gjersa jemi njëlloj hekzapodë
nuk është e drejtë,
që mizës bletë
njeriu t'i bëjë kaqë ndere,
siç janë zgjoj edhe koshere,
mes lulesh plot
dhe në dimër çdo mëngjes
e gostit me sherbet në vend të kafesë.
Ky është një privilegj i rrallë,
një hatërrlëk i paparë
dhe nuk e di
në ç'krushqi i ka rrënjet kjo miqësi;
por mund të them hapur e me zë:
bleta ka vitaminën «m».
— Po unë, — i tha bleta me zë të qetë, —
zgjojtë nuk i dua për rehat dhe gjumë,

po për punë
dhe lulet s'i dua për xhiro në behar,
po për të mbledhur nektar,
pra, për kujdesjet, që thua, kam nevojë,
që mjaltë më shumë të prodhoj,
kurse ti, jo vetëm që gjë me vlerë nuk
prodhon,
por ngado që shkon
përhap mikrobe dhe infeksion.

Q Y L I

Tek shkontakte ariu nëpër pyll,
gjeti një guvë me mjaltë dhe me dyllë
e buzëgeshi,
llërët përveshi
e zuri të hajë mjaltë me kënaqësi,
por bletët nga qenë dhe nga s'qenë
iu vërsulën batërdi
me thumba,
sa koka iu bë tërë xhunga.
Ariu s'duroi dot,
por duke qarë me lot
ua mbathi këmbëve



e tha me vete:

— Gjersa ishte qyl,
jo mjaltë,
por edhe thes me kripë po të ish,
do ta haja me gaz,
veç q'e do, qyli gjithmonë i ka thumbat
pas!

U J K U D H E Q E N G J I

Dikur ujku, qengjit prerë i tha:

— Do të të ha!

Tani ujku është bërë më i rrafinuar,
se shtruar qengjit i tha:

— O vëlla,

tërë bota më ka urryer,
se të kam ngrënë dhe shqyer,
por... kjo nuk do të ndodhë kurrë,
të jap fjalën si burrë,
jo qimen, por zakonin kam ndërruar.

Të betohem. Ke për ta provuar.

Do të bashkëjetojmë në harmoni
si miq dhe shokë të vërtetë,
kullot i qetë, luaj, blegëri,
këndo tërë gaz,

unë, për nder, nuk do të ngas,
rri pa merak,

nga ty dua vetëm pak... gjak!


Dhe ujku tinzar,

duke e siguruar për miqësinë,
ia nguli dhëmbët thellë në shpinë...

LOPA DHE PULA

Një pulë kish që në mëngjes,
që kakariste pa pushim,
me zërin tërsëllimë,
sa tërë fshati e mori vesh,
se pula kish bërë vezë.

Por, më së fundi një lopë,
iu lut ta linte atë potere,
që binte si çekan në kokë.



Pula i tha: — Ta marrësh vesh mirë,
se nuk është fjala për qumësht a për hirrë,
por për një vezë,
pra duhet shitur kjo, dhe unë di ta shesë!

— E mora vesh, — tha lopa, —
bile e pashë, kur e gëlltiti një vocrrak,
prandaj të lutem ule pak! —

— Jo, jo kam bërë një vezë
dhe veza bëhet zog,
prandaj do kakaris dhe zërin s'e ul hiç! —

Atëherë lopa i tha:

— Kur ti bëje vezën, unë linda një viç,
dhe viçi bëhet ka,
këtë besoj e di,
prandaj mjaft e shite, na lerë në qetësi! —

BLETA DHE KERMILL

— Habitem me ty, moj bletë,
që bredh lule më lule
poshtë e përpjetë.
Shikomë mua si rroj i qetë
e marr jetën ngadalë e shtruar,
sic dua vetë,
dhe, megjithëse pak lëviz,
shtëpinë e mbaj pérherë në kurriz.

Veçse natyra më ka bërë një padrejtësi
dhe keq më vjen, moj bletë,
që nuk kam fletë
si ty të fluturoj,
nga qejfi të ma dojë! —
Bletës më s'iu durua,
ndaj ia preu me zjarr:
— Kur punoj,

ndjej se jetoj pér shoqërinë,
po ti, more... kërmill,
që jetën e merr javash, si një bandill
e sehirxhi qëndron në guackë i qetë,
na dashke dhe fletë?!

Kot e ke.

Ti s'mundesh kurrë të fluturosh.

Po kur s'punon e nuk lëviz
e pér asgjë s'ke sedër e merak,
dije mirë,
dhe krahë të keshë
pak nga pak
shndërrrohen në guackë. —

Dhe fluturoi bleta në hapësirë.

K U R E B Ë N «R R U G Ë»


Na rrëmbeu dhelpra një pulë
dhe u zhduk.

Por pastaj e bëri rrugë
edhe erdhi përsëri.

Një natë, . . . dy.

Dy pula, . . . tri.

Po kjo punë nuk shkoi gjatë,
sepse ndrikulla një natë
na takoi me rojtarin, . . .
gëzoftarin!



A N K I M E T E M A J M U N I T

Nga «Zoollogjiçeskij sad»
një herë
doli tërë mllef dhe indinjatë
një majmun
dhe vajti drejt e te një berber
e i tha:
— Kam ardhur flokët, për të prerë,
o vëlla,
se jemi shtuar shumë
e nuk kemi më vlerë,
s'kam as leverdi,
po të më marrin edhe mua për njeri!

- EPIGRAME -

«S H O K U T»

— Në bulevard i krekosur kur kalove,
të përshëndeta, por fare s'më shikove,
veç kur shi i vrullshëm zuri të bjerë,
pranë çadrës m'u afrove menjëherë
e nën ombrellë më fole për shoqëri,
më fole... gjersa pushoi së rëni shi.



D E M B E L I

Tek rrinte dembeli në lëndinë,
qielli u nxi e zuri shi,
të gjithë u futën me vrap diku,
i thirrën edhe atij:

— U lage, po eja këtu!

— More vij, — i tha, — se nuk përtoj,
po më mirë po e pres këtë re, sa të kalojë!



MIKROBORGJEZI PAS MBLEDHJES

— Më kritikoi filani dhe ç'kritikë!
Për sy e faqe e pranova, por nuk ka gjë,
përgjigjen do t'ia jap më mirë ndonjë ditë
se ka kohë që ruaj në xhep një kleçkë
për të.

N JË R O J E N A T E

— Shëët, shokë, i vini kapak shamatës,
se është vonë, mezi i natës,
mos ia prishni qetësinë natyrës
dhe rojes që fle gjumë...
në krye të detyrës.



P E S Ÿ S

Për nënta e dhjeta s'e bëj kokën dhallë,
me ty kënaqem pesë, të puth në ballë,
veç një frikë të kam, moj e uruar,
se je fare pranë katrës së mallkuar!

T I F O Z I

Mbas operacioni një mjek
e pyeti pacientin në ndjehej i qetë,
por i sëmuri na ishte tifoz
dhe iu përgjegj nervoz:
— Sikur sulmuesi ynë,
të mos kishte gjuajtur ashtu... kuturu,
por sa ta çikte lehtë,
topi me siguri do të kishte hyrë në rrjetë...
Atëherë po, do të isha i qetë!

P R E P O T E N T I

— Djall o punë, kjo sëmundje e mallkuar
të priten këmbë dhe duar
e s'i përplas dot as në dysheme,
as në tavolinë
dhe zëri humb fuqinë,
tonalitetin,
zëri im që matej me tërmetin,
tani po rri i heshtur, pa qejf,
siç rrija para se të bëhesha shef.



H I P O K R I T I

— Këtu prehet ai që më deshi,
na buzëqeshi,
që prapashpine na shau e na përqeshi,
që na bëri qejfin, por kurrë punën,
që nga frynte era, kthente gunën.

M E N D J E M A D H I

Në agoni u tregua i sinqertë:
— Kur të më ngrini,
mos u çuditni që e kam kokën të lehtë,
kjo është arsyjeja,
që e mbaja përpjetë!

S E R V I L I

— Kur ju shoh pranë
më bëhet qejfi,
veç vdes me merakun,
përse nuk erdhi shefi!

P A T R I A R K A L I

— Mos qani,
vdes krenar,
se e di që mustaqet
rriten dhe në varr!

B U R O K R A T I

— Mos qani, të dashur miq të
mij,
edhe sot nuk vdes,
ejani një herë
nesër në mëngjes!

PASQYRA E LËNDËS

VJERSHA

Shkëndija nga metalurgjia	5
Qoshja jonë	9
«Këshilla» e shpërdoruesit	11
«Kritikë»	13
Burokrati	14
Ombrella	17

FABULA

Qajnë me lot dhelpër, ujk e çakall, se shqiponja i ka shtënë në hall.	23
Pjellë e keqe	25
Një udhë	27
Kau dhe ujku	28
Bleta dhe miza	30
Qyli	32
Ujku dhe qengji	34
Lopa dhe pula	35
Bleta dhe kërmilli	37
Kur e bën «rrugë»	39
Ankimet e majmunit	40

EPIGRAME

Shokut	43
Dembeli	44
Mikroborgjezi pas mbledhjes	45

Rojes së natës	46
Pesës	47
Tifozi	48
Prepotenti	49
Hipokriti	53
Mendjemadhi	54
Servili	55
Patriarkali	56
Burokrati	57